


KOSOVA DEMOKRATIKE



FORMA E QEVERISJES NË KOSOVË

ALBERTI (10), ERZA (10), TAULANT (10), SANIJE (10), ERIS (10), EDINA (10), ARTI (11), LEONITA (10),

EGZON (10)



Demokracia është formë e qeverisjes e cila na mundëson që ne të shprehemi lirshëm

Demokracia është lloj i qeverisjes, ku të gjithë i kanë të drejtat e barabarta. Demokracia është formuar në vitin 507 para erës sonë. Megjithatë, në Kosovë demokracia ka hyrë në funksion në vitin 2008. Kjo ndodhi me shpalljen e Kosovës shtet të pavarur dhe demokratik nga udhëheqësit tanë.

Më parë kemi menduar se demokracia është vetëm diçka që neve na lejon të shprehemi lirshëm. Por sot, mësuam se demokracia është shumë më shumë se aq. Në demokraci, qytetarët janë të barabartë para ligjit pa dallim feje, gjinie, race, etnie, moshe dhe kombi. Pastaj, ata gëzojnë të drejta të shumta siç janë: e drejta e shkollimit, e drejta e punës, e drejta e lëvizjes së lirë dhe shumë të drejta të tjera. Në shtetin tonë kemi demokraci përfaqësuese të sistemit parlamentar. Me këtë kuptojmë se ne qytetarët e Kosovës dalim në zgjedhje dhe votojmë për përfaqësuesit e shtetit, të cilët janë deputetët. Kurse, deputetët e zgjedhin Presidentin. Të mirat e demokracisë janë të pafundme. Themi kështu sepse vetitë më të mira njerëzore janë edhe elementet e demokracisë, numërojmë: solidaritetin, tolerancën, respektin, paqen, etj. Këto veti të cilat i cekëm më lart, janë pjesë e përditshmërisë sonë.


Në vazhdim do ta tregojmë një ngjarje ku ne si nxënës të klasës së V-të bashkërisht me mësuesen, kemi organizuar një aksion humanitar, ku secili prej neve kemi

përgatitur ëmbëlsira të ndryshme dhe kemi mbledhur veshmbathje, për t'i dërguar në jetimore.

Ne kemi një mesazh për ju lexues të nderuar, e ai është se nëse dëshironi që shteti ynë të jetë edhe më i zhvilluar dhe të njihet nga shtetet e ndryshme, së bashku duhet të punojmë shumë dhe ta tregojmë mençurinë tonë para botës.



Gazetarët e Kuvendit të Kosovës



Disa elemente të demokracisë

TË GJITHË JEMI TË BARABARTË

ENIS (10), ELVIRA (10), JETMIR (10), SEMINA (10), RINOR (11), HARIS (10), ARTESA (12), KALTRINA (11)

Lexues të dashur, sot nga ne do të mësoni për zgjedhjet dhe për rolin e zgjedhjeve në një shtet demokratik


Zgjedhjet janë procesi më i rëndësishëm demokratik. Me anë të zgjedhjeve, ne votojmë për deputetët dhe kryetarët e komunave përkatëse. Këto janë dy lloje të zgjedhjeve që i kemi në Republikën e Kosovës. Me anë të zgjedhjeve zgjedhim edhe kryetarin e klasës, por për të marrë pjesë në zgjedhje shtetërore duhet ta kemi moshën 18 vjeçare. Kjo sepse në këtë moshë jemi më të pjekur dhe e dimë më mirë se kë duhet ta votojmë. Roli i zgjedhjeve është mjaft i madh. Përmes tyre ne e kemi të drejtën të shprehemi lirshëm. Të drejtën e votës e ka çdo njeri në Kosovë pa marrë parasysh gjininë, fenë, racën, etj. Të votosh do të thotë të ndryshosh të ardhmen e vendit tuaj. Prandaj, kur të arrini këtë moshë, bëhuni pjesë aktive e zgjedhjeve. Vota juaj ka vlerë.



Ne jemi e ardhmja e vendit




Të gjithë duam të jetojmë në paqe



Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik




Dy llojet e zgjedhjeve në Kosovë janë: zgjedhjet lokale (komunale) si dhe ato qendrore (parlamentare)



Voto dhe ndrysho të ardhmen tënde dhe bëhu pjesë e vendimmarrjes në shtet

VENDI I LIGJEVE

ELZON (10), ANITA J. G. (10), ANITA M. G. (10), AURELA (10), FLAMURI (9), OLTION (11), ARLINDI (11),
ERIONI (10), XHEMILE (11)




Nëse dëshironi të dini më shumë për funksionet e Kuvendit, atëherë lexoni këtë artikull

Demokracia nënkupton të drejta të barabarta pa dallim feje, etnie apo gjinie. Disa elemente kryesore në demokraci janë: liria, të drejtat e barabarta dhe toleranca. Nëse ne jemi të lirë nuk do të thotë që ne mund të bëjmë çfarë të na vie në mend, por duhet të mendojmë për të gjithë.

Kuvendi është organ legjislativ, aty marrin pjesë 120 deputetë. 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, ndërsa 20 të tjerë janë nga komunitetet jo shumicë. Çdo njeri që përmbush disa kriteret dhe që ka arritur moshën 18 vjeçare, mund të kandidoj për deputet. Çdo ligj që propozohet në Kuvend shqyrtohet nga komisionet parlamentare. Nëse propozohet një ligj nga Ministria e Arsimit, atë e shqyrton Komisioni për Arsim. Ndërsa, për miratimin ose jo miratimin e tij votojnë të gjithë deputetët. Kështu pra, komisionet i shqyrtojnë ligjet përkatëse, ndërsa të gjithë deputetët janë ata të cilët i votojnë ato, kurse Qeveria i zbaton. Kuvendi ka tri funksione kryesore: funksionin legjislativ, përfaqësues dhe atë kontrollues. Ka funksion legjislativ, që do të thotë se në Kuvend miratohen ose nuk miratohen ligjet e propozuara. Ka funksion përfaqësues, që do të thotë deputetët e zgjedhur e përfaqësojnë popullin. Si dhe Kuvendi kontrollon Qeverinë, prandaj ka funksion kontrollues. Grupi ynë ka një mesazh për ju të dashur lexues: mos nënçmo njerëzit nëse nuk i përkasin

kombit, fesë apo racës tënde. Ai/ajo ka vlerat e tij/saj njerëzore dhe të gjithë i kemi të drejtat e barabarta.



Ligjet miratohen ose nuk miratohen në Kuvend, i cili është institucioni më demokratik i vendit



Gazetarët e mençur

DEMOKRACIA DHE QYTETARIA AKTIVE

RINOR (10), ARDIT (10), MUHAMET (11), LAURENT (11), SIBORA (10), ERZA (10), EROJNA (11),
ARJETA (10), FLORINA (11)

Ne si qytetarë aktiv, në këtë artikull do t'iu informojmë më shumë për pjesëmarrjen aktive

Demokracia është formë e qeverisjes, që nënkupton të drejtat e barabarta të qytetarëve, pa dallim gjinie, moshe, etnie, race, besimi apo gjendje ekonomike. Pra demokracia me fjalë të tjera është zëri i popullit. Njëri prej elementeve kryesore të demokracisë është pjesëmarrja. Me pjesëmarrje kuptojmë kur qytetarët marrin pjesë në zgjedhje, në seancat plenare të Kuvendit dhe në iniciativa të ndryshme qytetare. Iniciativë qytetare mund të jetë ndihma ndaj të sëmurëve kur ata kanë nevojë për ne, të bashkëpunojmë për ta pastruar mjedisin tonë, etj. Ne jemi të vegjël, por edhe ne jemi qytetarë aktiv sepse i ndihmojmë të tjerëve dhe marrim pjesë në procese të ndryshme për të mirën e vendit tonë.




Autorët e këtij artikulli



Iniciativa e një qytetari



Qytetarët duke votuar



T'i hedhim mbeturinat aty ku e kanë vendin



Liri dhe paqe për të gjithë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Ali Kelmendi“
Klasa: V-4
Vendi: Vushtrri